

PKL-KZZ 76/08
06 prill 2009

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

E përbërë prej gjyqtarëve në vijim:

MARIA GIULIANA CIVININI	Kryetare e kolegjit	Gjyqtare e EULEX-it në GjS
GUY VAN CRAEN	Anëtar	Gjyqtar i EULEX-it në GjS
EMILIO GATTI	Anëtar	Gjyqtar i EULEX-it në GjS
AGIM KRASNIQI	Anëtar	Gjyqtar në GjS
AVDI DINAJ	Anëtar	Gjyqtar në GjS

Në rastin kundër të akuzuarit:

D. G. (i lindur më [redacted] in [redacted]), nga i ati M. dhe nëna T. (mbiemri i vajzërisë N.), nga fshati [redacted], Komuna [redacted], Rajoni [redacted], Kosovë.

Për veprë penale Vrasje në kundërshtim me nenin 112 të Kodit Penal të Zvicrës (KPZ); Vrasje e mundshme me qëllim në kundërshtim me nenin 111 të KPZ-së, Veprime të shumëfishta seksuale me fëmijë në kundërshtim me nenin 187 të KPZ-së, Lëndime të shumëfishta trupore në kundërshtim me nenin 123 të KPZ-së, Dhunim të shumëfishtë në kundërshtim me nenin 190 të KPZ-së, Shtrëngim të shumëfishtë në kundërshtim me nenin 181 të KPZ-së, Akuzim të rrejshëm dhe/ose nxitje në kundërshtim me nenet 303 dhe 24 të KPZ-së, Dhunë dhe kërcënim kundër autoriteteve dhe zyrtarëve në kundërshtim me nenin 285 të KPZ-së, dhe Veprime të ndëshkueshme përgatitore për vrasje ose rrëmbim të qëllimshëm në kundërshtim me nenin 260 të KPZ-së.

* Duke vepruar sipas kërkesës mbi mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar më 24 korrik 2008 nga Prokurori Publik i Kosovës kundër aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PN-KR 335/2007, të datës 28 mars 2008

VENDIM

Kërkesa mbi mbrojtjen e ligjshmërisë është vërtetuar si e bazuar mirë. Aktvendimi i shkallës së dytë i datës 28 mars 2008 ka shkelur ligjin duke marrë parasysh se Kushtetuta që nuk është më në fuqi dhe për tani e pazbatueshme në Kosovë pamundësoi transferimin e D. G. në Zvicër në përputhje me nenin 457 par. 2 të KPPK-së.

ARSYETIMI

Historia Procedurale

D. G. është kërkuar nga autoritetet Zvicerane me pretendim të ketë kryer veprat e shënuara më lart.

Faktet e rastit, siç pretendojnë autoritetet Zvicerane, janë se përafërsisht në mes viteve 1995/96 deri në Janar 1999, Z. G. ka kryer veprime të shumëfishta dhunimi dhe keqtrajtim seksual e fizik dhe dhunë kundër të bijës së tij, B., të lindur më në

Bazuar në rindërtimin e ngjarjeve të bëra nga autoritetet Zvicerane, kur mësuesi i Besartës, Z. P. S., kuptoi për keqtrajtimin kundër saj, Z. G. vendosi të eliminojë dëshmitarin e keqtrajtimit të tij. Më 11 Janar 1999, Z. Gecaj qëlloi dhe vrau Z. S.-in dhe pas pak kohe iku nga Zvicra për në Serbi dhe Mal të Zi pa u ballafaquar me drejtësinë për këtë veprë. Para se të ikte nga Zvicra Z. G. po ashtu bëri veprën dhunë dhe kërcënim kundër autoriteteve dhe zyrtarëve Zvicerane.

Më 25 shkurt 1999, i pandehuri u arrestua në Kosovë dhe u akuzua sipas Ligjit mbi Procedurën Penale të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1977. Ai u paraqit para Gjykatës së Qarkut në Pejë më 1 mars 1999 dhe u mbajt në arrest nën juridiksionin e Gjykatës së Qarkut në Pejë sipas urdhrit të gjykatës për paraburgim.

Pas miratimit të Rezolutës 1244 të KSKB dhe me hyrjen e saj në fuqi, më 27 shtator 1999, Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë ndërroi vendin e rastit nga Peja në Gjykatën e Qarkut në Leskovc “[...] për qëllime të përshtatjes së procesit” [...] “pasi

që është e qartë se procedura do të drejtohet më lehtë para Gjykatës së Qarkut në Leskovc” në përputhje me nenin 35, paragrafët 1 dhe 3 të ligjit të përmendur.

Më 7 dhjetor 2000, i pandehuri është dënuar nga ana e Gjykatës së Leskovcit me katër vite burgim për vrasje sipas nenit 47, par 1, të Kodit Penal të Serbisë. Ai është liruar nga paraburgimi i procedurës paraprake më 7 dhjetor 2000, duke pritur aktgjykimin e formës së prerë nga Gjykata Supreme e Serbisë. Vendimi ishte konfirmuar nga Gjykata Supreme e Serbisë më 28 mars 2002 dhe më 28 maj 2003, me miratimin e kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, dënimi ishte zvogëluar në tri vite e gjashtë muaj burgim duke u llogaritur dënimin e vuajtur prej datës 27 shkurt 1999 deri 7 dhjetor 2000.

Më 19 maj 2003 dhe më vonë më 6 dhjetor 2005, autoritetet Zvicerane lëshuan një urdhër arresti për të pandehurin për veprat penale të përmendura më lart.

Më 22 shkurt 2006, Drejtori i Zyrës Federale Zvicerane të Drejtësisë konfirmoi miratimin e propozimit të PSSP-së për nxjerrjen e një marrëveshjeje lidhur me ekstradimin e të pandehurit. Më 4 maj 2006, i pandehuri është arrestuar në Kosovë dhe, të nesërmen, gjyqtari i procedurës paraprake i UNMIK-ut në Pejë urdhëroi të pandehurin të paraqitet në stacionin policor në kohën e caktuar. Ai u lirua ditën e njëjtë. Më 7 maj 2006, duke vepruar sipas ankesës së PP, kolegji i UNMIK-ut në Gjykatën e Qarkut në Pejë caktoi paraburgimin kundër G███-t i cili u arrestua vetëm më 13 gusht 2007. Në ditën e njëjtë, gjyqtari i procedurës paraprake caktoi masën paraburgimit kundër të pandehurit.

Më 17 gusht 2007, duke vepruar sipas ankesës së avokatit mbrojtës, kolegji prej tre gjyqtarësh të UNMIK-ut në Gjykatën e Qarkut në Pejë përfundoi paraburgimin lidhur me veprat penale vrasje, akuzim të rrejshëm dhe nxitje dhe konfirmoi paraburgimin për veprat penale veprime të shumëfishta seksuale me fëmijë, lëndime të shumëfishta trupore, dhunim të shumëfishtë, dhunë dhe kërcënim kundër autoriteteve dhe zyrtarëve, Veprime të ndëshkueshme përgatitore për vrasje ose rrëmbim të qëllimshëm.

Më 20 gusht 2007, një propozim i ri i Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara (PSSP) Z. Rücker i datës 3 gusht 2007 për transferim të Z. G███-t, është pranuar nga Ministrja Federale e Punëve të Jashtme të Zvicrës Znj. Micheline Calmy-Rey.

Më 3 shtator 2007 gjyqtari i procedurës paraprake i UNMIK-ut i Gjykatës së Qarkut në Pejë sipas nenit 521, par. 2 të KPPK-së vendosi se parakushtet për transferimin e D. G. në Zvicër janë plotësuar për veprat penale: 1) *Veprime të shumëfishta seksuale me fëmijë* 2) *Lëndime të shumëfishta trupore*, 3) *Dhunim të shumëfishtë*, 4) *Dhunë dhe kërcënim kundër autoriteteve dhe zyrtarëve*, 5) *Veprime të ndëshkueshme përgatitore për vrasje ose rrëmbim të qëllimshëm*.

Më 5 nëntor 2007 kolegji prej tre gjyqtarëve i UNMIK-ut i Gjykatës së Qarkut në Pejë lëshoi aktvendimin e tij duke pranuar kërkesën për transferimin e të pandehurit në Zvicër për akuzat penale të: 1) *Vrasjes në kundërshtim me nenin 112 të Kodit Penal Zviceran (KPZ)*, 2) *Vrasje e mundshme me qëllim në kundërshtim me nenin 111 të KPZ-së*, 3) *Veprime të shumëfishta seksuale me fëmijë në kundërshtim me nenin 187 të KPZ-së*, 4) *Lëndime të shumëfishta trupore në kundërshtim me nenin 123 të KPZ-së*, 5) *Dhunim të shumëfishtë në kundërshtim me nenin 190 të KPZ-së*, *Shtrëngim të shumëfishtë në kundërshtim me nenin 181 të KPZ-së* 5) *Akuzim të rrejshëm dhe/ose nxitje në kundërshtim me nenet 303 dhe 24 të KPZ-së*, 6) *Dhunë dhe kërcënim kundër autoriteteve dhe zyrtarëve në kundërshtim me nenin 285 të KPZ-së*, dhe 7) *Veprime të ndëshkueshme përgatitore për vrasje ose rrëmbim të qëllimshëm në kundërshtim me nenin 260 të KPZ-së*.

Kundër këtij aktvendimi është parashtruar ankesë. Gjykata Supreme e Kosovës, me vendimin e tij më 28 mars 2008, ka vendosur se “vendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë i datës 5 nëntor 2007 në rastin PP Nr 469/06 (Sek. 15/06) përmes kësaj ndryshohet dhe kërkesa për transferimin e D. G. në Zvicër refuzohet si e pabazë sipas nenit 434, Paragrafit 3 të KPPK-së”.

Më 24 korrik 2008 është parashtruar një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër këtij Aktvendimi duke kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që “nën kompetencën e KPPK-së, nenit 457, paragrafit 2, të konstatojë se” kërkesa “është bazuar mirë dhe të përcaktojë se aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë i datës 28 mars 2008 ka shkelë ligjin duke pasur parasysh se kushtetuta që nuk është më në fuqi dhe aktualisht e pazbatueshme në Kosovë pamundësoi transferimin e Dedë Gecaj-t në Zvicër”.

Motivacioni

Mbi kompetencën

Dosja, lidhur me rastin e caktuar tek gjyqtarët ndërkombëtarë më 21 gusht 2008 sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/64, është dorëzuar te Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it e cila ka vendosë të mbajë rastin nën përgjegjësinë e Gjyqtarëve EULEX-it bazuar në nenin 15.2 të Ligjit mbi Juridiksionin.

Mbi pranueshmërinë e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Sipas nenit 451 të KPPK-së kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të parashtrohet “kundër një vendimi gjyqësor përfundimtar apo kundër procedurave gjyqësore që paraprinë marrjen e atij vendimi”.

Kolegji llogarit se aktvendimi i Gjykatës Supreme i datës 28 mars 2008 paraqet të gjitha elementet e një “vendimi gjyqësor përfundimtar”.

Ky është një “vendim gjyqësor” në kuptim të nenit 451 për këto arsye: 1) në bazë të parimeve të përgjithshme, kur Ligji e dorëzon një çështje në përgjegjësi të gjyqësorit, veprimi konsekuent është juridiksional dhe vendimet e marra kanë natyrë të vendimeve gjyqësore; 2) në secilin rast, procedura e ekstradimit dhe vendimi relevant nuk kanë natyrë administrative, madje as në pikëvështrim material; në fakt, sipas ushtrimit të nenit 521 dhe në përputhje me KPPK-në, 2a) Gjyqtari i procedurës paraprake ka autoritet të urdhërojë “veprime tjera hetimore” për të siguruar nëse parakushti i paraparë me nenin 517 n. 7 është ekzistues; 2b) aktvendimi refuzues përfundimtar nuk i len asnjë hapësirë autoritetit kompetent politik për vlerësime të mundshme (neni 522, par. 3: aktvendimi përfundimtar me të cilin është refuzuar transferimi duhet të transmetohet përmes entitetit kompetent publik në fushën e çështjeve gjyqësore deri te autoriteti kompetent që duhet me këtë të njoftojë shtetin e huaj.”); 2c) në rast se aktvendimi miraton transferimin, autoriteti kompetent mund vetëm të: - shtyjë transferimin për të lejuar mbajtjen e një procedure në vazhdim e sipër para një gjykate vendore apo ekzekutimin e dënimit; - refuzojë transferimin nëse parakushtet si neni 517 nuk plotësohen ose krimi për të cilin është bërë kërkesa

për transferim është e dënueshme deri në 3 vite burgim apo për të cilin gjykata e huaj kishte vendosë një dënim deri në një vit burgim; 2d) si pasojë transferimi mund të refuzohet vetëm në bazë të arsyeve të ligjshmërisë (apo në lidhje me administrimin e drejtësisë) dhe jo për arsye të mundësisë së zgjedhjes (siç ishte e mundur sipas Ligjit mbi Procedurën Penale të vitit 1986, neni 533); 2f) si konstatim, procedura e përcaktuar me Kodin- e karakterizuar me: mundësinë e hetimeve të reja, vendimin mandator negativ, mbizotërimi i kriterëve të ligjshmërisë mbi kriteret e mundësisë së zgjedhjes – është plotësisht juridiksional.

Është “i formës së prerë”, sepse mjetet e zakonshme nuk janë të pranueshme. Është e dobishme të theksohet se, me “aktgjykimin” e tij të datës 4 gusht 2005 (të pandehurin Ridvan HALIMI), Gjykata Supreme e Kosovës vendosi mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me ekstradimin në juridiksionin Norvegjez, duke e konsideruar mjetin si absolutisht të pranueshëm.

Mbi ekstradimin e një qytetari të Kosovës

Me aktvendimin e datës 28 mars 2008, Gjykata Supreme e Kosovës ndryshoi aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 5 nëntor 2007 dhe refuzoi kërkesën për transferimin e të pandehurit, duke argumentuar se: a) në kohën e kryerjes së pretenduar të krimeve, D. G. ishte qytetar i Serbisë dhe, në bazë të parimit të ligjit më të favorshëm (neni 2 KPK), ai kishte të drejtë të mos ekstradohej nga Jugosllavia e drejtë e dhënë nga ish Jugosllavia dhe nga Kushtetutat e Serbisë; b) në atë kohë nuk kishte asnjë marrëveshje në fuqi në mes Jugosllavisë dhe Zvicrës. Prokurori Publik pretendon se parimi i ligjit më të favorshëm i takon ligjit material penal e jo procedurës së transferimit.

Gjykata konstaton se:

- Parimi i ligjit më të favorshëm është i përcaktuar më nenin 2,1 par. 2 të KPK-së i cili përcakton se “në rast të ndryshimit të ligjit në fuqi në një rast të caktuar para vendimi përfundimtar, duhet të zbatohet ligji më i favorshëm për kryerësin”.
- Parimi i referohet në mënyrë të qartë zbatimit të ligjit material penal e jo ligjit të procedurës siç është e qartë me kombinimin e neneve 1 (parimi i ligjshmërisë dhe nën-parimi apo jo-retroaktiviteti i ligjit material penal) dhe 2, par 1 tëKPK-së.

- Rregullat mbi ekstradimin (ekstradimet procedurale dhe ekzekutive) janë rregulla procedurale që shihet qartazi se nuk janë të përfshira në dispozitë të ligjit penal si elemente të krimit tipik.
- Rregullat procedurale zbatohen si në procedurë që është në vijim e sipër ashtu edhe në procedurë të re dhe koha e kryerjes së krimit të pretenduar nuk është me rëndësi, (shih nenin 548 , KPPK).
- Kur procedura e ekstradimit për transferimin e të pandehurit filloi, Kushtetutat e RFJ-së dhe Republikës së Serbisë më nuk ishin në fuqi në Kosovë. Në atë kohë të dyja ishin zëvendësuar me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, duke mos përfshirë të drejtën e qytetarit për tu mos ekstraduar), Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26, Rregullorja e UNMIK-ut 2003/34, dhe KPPPK, që thotë në nenin 533 se: “Pavarësisht nga neni 517 nënparagrafi 1 i këtij Kodit, qytetari i Kosovës mund të transferohet në juridiksion të huaj nëse: 1) Transferimi i tij/saj është i lejuar me një marrëveshje ndërkombëtare; dhe 2) Janë plotësuar të gjitha parakushtet për transferim të përcaktuara me nenin 517 të këtij Kodi, përveç nënparagrafit 1.”

Mbi ekzistimin e marrëveshjes së vlefshme ndërkombëtare

Më 22 shkurt 2006 ishte nxjerrë një marrëveshje ndërkombëtare *ad hoc* në mes UNMIK-ut dhe Zvicrës lidhur me ekstradimin/transferimin e të pandehurit; kjo ishte zëvendësuar me një marrëveshje të re *ad hoc* më 20 gusht 2007 të nënshkruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) Z. Rücker dhe Ministrija Federale e Punëve të Jashtme të Zvicrës Znj. Micheline Calmy-Rey.

Autoriteti i dhe baza ligjore e PSSP-së është Rregullorja e UNMIK-ut 2003/34, nenet 2 dhe 3, që vlen “për veprat penale të kryera para datës së hyrjes në fuqi së kësaj Rregulloreje që do të përbënte veprat penale në kohën e kryerjes së tyre” (që është edhe rasti i veprave penale që pretendohet ti ketë kryer i pandehuri).

Marrëveshja është ende e vlefshme sipas nenit 145 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Vazhdimësia e marrëveshjes ndërkombëtare dhe legjislacioni i zbatueshëm”).

Mbi zbatimin e parimit "ne bis in idem"

Siç është thënë në "historinë procedurale", D. G. është dënuar nga Gjykata Serbe për veprën kriminale Vrasje.

Vendimi nuk mund të merret parasysh në perspektivën e zbatimit të parimit "ne bis in idem". Në fakt, marrëveshja për transferim e datës 20 gusht 2007 qartazi vërteton se transferimi nuk do të pranohet "nëse qytetari është falur apo dënuar në një Gjykatë në Kosovë me aktgjykim të formës së prerë për veprën penale për të cilën kërkohet transferimi" (neni 5 pika g), me përjashtim të aktgjykimeve të Gjykatave jo-vendore.

Prandaj, Gjykata Supreme Kosovës vendosë sikur në dispozitivin e këtij vendimi.

Prishtinë, 6 prill 2009

Kryetarja e Kolegjit
Maria Giuliana Civitini

Anëtari i Kolegjit
Guy Van Craen

Anëtari i Kolegjit
Aydi Diraj

Procesmbajtësja

Edita Kusari

Anëtari i Kolegjit

Emilio Gati

Anëtari i Kolegjit

Agim Krasniqi